



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 25 maj 2017, në mbledhjen e XL - të (dyzet)- e jashtëzakonshme, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht Kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS), Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), Muharrem Haziri, OSBE.

Rendi i ditës

- Ri - alokimi i buxhetit të Komunës për vitin 2017

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo mbledhje e jashtëzakonshme është thirr në konsultim me shefat e Grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend të Komunës.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, zakonisht në këtë kohë do duhej të shqyrtohej rishikimi i buxhetit, në këtë kontest Qeveria e Republikës së Kosovës përkatësisht Ministria e Financave, më datën 8 maj 2017 e ka dërguar një instruksion për rishikim të buxhetit, instruksion të cilin ne e kemi pranuar një ditë më vonë, dhe ne kemi filluar përgatitjet për rishikimin e buxhetit të Komunës, mirëpo situata e cila ndodhi pas datës së cekur na detyroi të konsultojmë Ligjin për Financat Publike dhe Ligjin për Buxhetin e vitit 2017, në mënyrë që për shkak të procedurave dhe vonesave të mundshme për miratimin e rishikimit të buxhetit e kemi gjetur hapësirën ligjore dhe jemi përcaktuar për ri – alokim apo siç unë shpesh e quaj ri rregullim të buxhetit, kuptohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në këtë dokument, e keni vërejtur se jemi marrë edhe me disa imtësira ngase buxheti i Komunës për vitin 2017 ka qenë i planifikuar sipas kategorive ekonomike por edhe sipas nënkategorive ekonomike si dhe planit kontabël sipas të cilit çdo kategori ekonomike ka qenë e ndërlidhur me nënkategorinë përkatëse ekonomike dhe nuk kemi mundur të zbatojmë metodat e vjetra por që këtë ri – alokim ta bëjmë sipas metodave dhe rregullave të reja.

Sigurisht e keni vërejtur se thuajse në të gjitha Drejtoritë ka pas planifikim për blerjen e kompjuterëve, i njëjti planifikim ka qenë edhe në vitin 2016, mirëpo kur është planifikuar buxheti për vitin 2017 nuk është ditur saktësisht se a do të ndodhin ato blerje, ato kanë ndodhur gjatë vitit 2016, mirëpo kanë qenë të planifikuara edhe në vitin 2017, andaj kjo është arsyeja që 90% apo 95% të atyre planifikimeve mjetet të ri - alokohen në kode për të cilat kemi konsideruar se ka mungesë të mjeteve.

Një pjesë e mjeteve është ri – alokuar edhe në investime kapitale për të cilat më detajisht arsyetimet do t'i paraqesin drejtorët e Drejtorive përkatëse.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, në kuadër të kësaj Drejtorie, me lejen e Ministrit të Ministrisë përkatëse e kemi propozuar ri – alokimin e mjeteve nga kodi 44624 në shumë prej 930.000 € për ndërtimin në qytet të bulevardit dhe sheshit “ Sheshi i Dëshmorëve “ – Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Ilir Konushefci.

Ne e kemi iniciuar procedurën e prokurimit për ndërtimin e shtatores së Heroit Ali Ajeti, ndërsa në bashkëpunim me nivelin qendror jemi në përgatitje për iniciimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin e shtatoreve të Heronjve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Ilir Konushefci.

Ri – alokimi i mjeteve nga kodi i cekur është bërë për shkak se dy parcela në qendër të qytetit janë kontestuese, njëra përballë restorantit “ Marigona “ dhe tjetra përball restorantit “ Kafja e Sabitit “ ngase një palë ka kërkuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit leje ndërtimore me dokumentacion në cilësinë e titullarit të atyre parcelave, natyrisht kërkesa është refuzuar dhe lënda është në shqyrtim nga ana e organit në shkallë të dytë.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, në kuadër të kësaj Drejtorie shuma e përgjithshme e ri – alokimit është 189.900 € nga buxheti i përgjithshëm që është 1. 770.200 € që në përqindje bie 10.73%, pra është shumë e ulët në krahasim me rishikimet e buxhetit që bëhen në këtë fazë të vitit.

Kryesisht mjetet ridestinoohen nga tri projekte dhe atë nga projekti, kolektori i ujërave të zeza Gërdoc – Shakovicë për arsye se ky projekt është pjesë e projektit të hartuar për ndërtimin e kolektorit kryesor për ujëra të zeza në Komunën e Podujevës, sipas Marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Austrisë.

Mjetet e ri – alokuara kemi menduar t'i parashohim në katër kode dhe atë për shtruarjen e rrugëve me zhavorr në shumë 58.000 €, ndërtimi i kanalizimeve fekale në shumë 51.900 €, trotuaret 66.000 € dhe riparim e ndërtim i urave në shumë prej 14.000 €.

Në vazhdim përmendi mbi 90% të rrugëve të cilat është planifikuar të shtrohen me zhavorr, ndërtimin e kanalizimeve, riparimin dhe ndërtimin e urave si dhe ndërtimin e trotuareve.

z. Durim Salihu, theksoi, lidhur me projektin, Hartimi i Planeve Rregulluese Detaje, në kërkesë të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, na është lejuar që ato plane të përgatiten nga stafi i Drejtorisë dhe duke u bazuar se ato mjete nuk janë shpenzuar është propozuar që të njëjtat të ridestinoohen si në materialin e propozuar.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, të gjitha sqarimet e nevojshme u paraqitën nga tre drejtorët, andaj unë nuk kam asgjë për të shtuar vetëm se na mbetet që në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të diskutojmë më gjerësisht.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, duke u bazuar se është vetëm një pikë e rendit të ditës, propozoj që propozimi i këtij Vendimi t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe më në detaje të diskutohet në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

z. Haki Rudari, theksoi, i dëgjuam sqarimet e tre drejtorëve të Drejtorive përkatëse, mirëpo vet fakti se është paraqitur nevoja për ri - alokim të mjeteve është dëshmi se nuk është bërë mirë planifikimi i projekteve.

Në disa kode ri - alokimi i mjeteve është i pa arsyeshëm, Ekzekutivi i Komunës këtë e ka pa të arsyeshme dhe i ka propozuar, mirëpo unë personalisht por edhe në cilësinë e shefit të Grupit të këshilltarëve të LVV – së jam kundër dhe shtoi, për cilat kode bëhet fjalë por edhe për kërkesat e qytetarëve nga mjedise të ndryshme, do t'i them në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ri – alokimi i mjeteve buxhetore është i paraparë me dispozita ligjore dhe nënligjore për arsye se në realizimin e projekteve një pjesë e mjeteve mund të teprojnë dhe të shkojnë në suficit, por ka edhe raste kur për realizimin e plotë të projekteve mungojnë mjete, andaj është e drejtë ligjore të plotësohen mjetet në projektet ku ka mungesë.

Përndryshe ri – alokimi i mjeteve bëhet për çdo vit.

Lidhur me propozimin e këtij Vendimi, çdo këshilltar e ka të drejtën të paraqet mendimin dhe propozimin e vet, mirëpo këtë do duhej bërë me argumente pa e politizuar çështjen.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij Vendimi, Kuvendit i rekomandohet njëzëri për shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj këtë mbledhje të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 13.35'.

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/01-010039606/17
Podujevë,
25 maj 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**